



(<https://www.kultplus.com>)

Shfaqet në Lucern drama e Jeton Neziraj, King Lori

2 SHKURT, 2022 - © 1:40 PM



King Lori – Instagrations, drama e autorit kosovar Jeton Neziraj do të shfaqet me datë 7 dhe 8 shkurt në Kleintheater Lucern të Zvicrës, në kuandër të festivalit Unfrisiert, përcjell KultPlus.

Në këtë shfaqje, me regji të Katharina Cromme, luajnë aktoret Sysanne Avelein dhe Marie Gesien. Drama është përkthyer në gjermanisht nga Andrea Grill. Menaxher i produksionit është Roland Amrein, kostimet dhe muzikën i ka punuar Bebi Hartig SCM, kurse skenografinë Lukas Stucki.

Shfaqja është prodhuar nga *Zürcher Institut für bewegende Künste* në bashkëpunim me Qendrën Multimedia nga Prishtina dhe *Kleintheater Luzern*.

Pas Zvicrës, shfaqja gjatë muajit Mars do të shfaqet edhe në Prishtinë, Gjilan e Ferizaj.

Origjina dhe 'kredibiliteti' i rrugës. Këngë dhe debate. Pushteti dhe media. Ndjekësit në rrjete sociale dhe zgjedhjet. *King Lori – Instagrations* është një dramë për dy personazhe imagjinare; Loredanën dhe Ylfeten. Përmes muzikës dhe debatit, shfaqja ndriçon makinacionet kontroverse të yllit të muzikës, Loredana dhe politikanës së suksesshme, Ylfetës. Të dyja nga Lucerni, të dyjat me sfond emigrimi. Por, krijuesit e kësaj shfaqjeje, megjithatë insistojnë që këto dy personazhe janë imagjinare. Si në ndonjë përrallë, ose nga Netflix-i, ose nga Instagrami./ **KultPlus.com**



SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

